

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

DHUNA NË FAMILJE

ÇFARË ËSHTË DHUNA NË FAMILJE?

Dhuna në familje mund të paraqitet si keqtrajtim, ofendim, rrezikim i sigurisë, lëndim trupor, dhunë gjinore apo dhunë tjetër psikologjike, fizike apo ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenja a pasigurisë, rrezikimit apo frikës, duke përfshirë edhe kërcënimet për veprimet e tilla ndaj bashkëshortit, prindërve apo fëmijëve apo personave tjerë të cilët jetojnë në bashkësi martesore apo jashtëmartesore apo ekonomi familjare të përbashkët, si dhe ndaj bashkëshortit të tashëm apo mëparshëm, bashkëshortit jashtë martesor apo personave të cilët kanë fëmijë të përbashkët apo ndodhen në marrëdhënie të afërta personale pa dallim nëse kryerësi e ndan apo ka ndarë vendbanimin e njëjtë me viktimën apo jo.

Dhuna në familje mund të paraqitet në këto forma: Dhuna në familje mund të paraqitet në këto forma:

- ✓ Dhunë në shtëpi, dhuna fizike, psikologjike apo ekonomike
- ✓ Përdhunimi apo sulmi seksual në martesë, jashtë martesës
- ✓ Keqpërdorimi seksual në fëmijëri
- ✓ Krime në emër të "nderit"
- ✓ Martesë e detyrueshme, martesë ndërmjet të miturve
- ✓ Shqetësimi seksual dhe eksploatimi seksual
- ✓ Ndjekja
- ✓ shqetësimi apo dhuna në vendin e punës apo hapësirën publike
- ✓ dhuna apo shqetësimi kibernetik

KUSH MUND TË JETË KRYERËS DHE VIKTIMË E DHUNËS NË FAMILJE?

Dhuna ndodh ndaj:

- ✓ Bashkëshortit,
- ✓ Prindërve apo fëmijëve apo personave tjerë të cilët jetojnë në bashkësi martesore apo jashtë martesore apo ekonomi familjare të përbashkët,
- ✓ Bashkëshorti i tashëm apo i mëparshëm, bashkëshorti jashtë martesor apo personat që kanë fëmijë të përbashkët apo ndodhen në marrëdhënie të afërta personale.

Konsiderohet si dhunë në familje, pavarësisht asaj nëse viktima apo kryerësit e ndajnë venbanimin e njëjtë në momentin e paraqitjes të dhunës.





KU TË DREJTOHEM NËSE JAM VIKTIMË E DHUNËS NË FAMILJE?

A. Në qendrat për punë sociale të Ministrisë të punës dhe politikës sociale në territorin e të gjithë shtetit.

Lista e Qendrave për punë sociale me kontakte nga persona të autorizuar është dhënë në këtë link:

www.mtsp.gov.mk/institucii.nspk

Qendra për punës sociale ndërmerr këto masa për mbrojtje të viktimave: akomodimin në qendër për persona – viktimë të dhunës në familje; mbrojtje përkatëse shëndetësore; iintervenim dhe trajtim përkatës psiko – social; trajtim psiko – social në këshillimore; ndihmë për familjen për shkollim të rregullt të fëmijës; ndihmë juridike dhe përfaqësim, dhe përforcim ekonomik të viktimës përmes përfshirjes të saj aktive në tregun e punës.

B. shoqata, të cilat janë të regjistruara për dhënien e shërbimeve për mbrojtje sociale.

Lista e shoqatave të regjistruara për dhënien e shërbimeve për mbrojtje sociale është e disponueshme në:

www.mtsp.gov.mk/registri.nspk

C. SOS Linjën mobile nacionale falas për viktimat e dhunës në familje

070/ 141 700

075/ 141 700

077/ 141 700



Ç. në stacionin më të afërt policor, drejtëpërdrejtë apo përmes telefonit:

192

D. Në një nga 34 njësitë më të afërta rajonale të Ministrisë të Drejtësisë, për marrjen e ndihmës juridike falas.

Dh. Te shoqatat e autorizuara për sigurimin e ndihmës juridike falas.

E. Njësitë e vetëqeverisjes lokale (komunat) të cilat në mënyrë të pashmangshme duhet t'ju udhëzojnë se ku të drejtoheni nëse nuk e keni informacionin paraprak për të njëjtën

Ë. Entet shëndetësore – të cilat janë të detyruara që menjëherë të kryejnë kontroll dhe trajtim tjetër mjekësorë të viktimës dhe për të njëjtin t'i japin dokumentacion përkatës mjekësor për lëndimin e konstatuar



ÇFARË LLOJI I MBROJTJES MË TAKON SI VIKTIMË E DHUNËS NË FAMILJE?

A. Masa e përkohshme për mbrojtje në procedurë civile

Me qëllim të ndërprerjes të dhunës, largimit të pasojave nga dhuna e kryer dhe ndërmarrjes të masave efikase ndaj kryerësit të dhunës, kryerësit të dhunës në familje mund t'i shqiptohen këto masa të përkohshme të mbrojtjes:

- ✓ Ndalim që të kërcënohet se do të kryejë dhunë në familje
- ✓ Ndalim që të keqtrajtojë, shqetësojë, telefonojë, kontaktojë apo në mënyrë tjetër të komunikojë me anëtarë të familjes, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo jo të drejtëpërdrejtë
- ✓ Ndalim që të afrohet në distancë më të vogël se 100 metra afër vendbanimit, shkollës, vendit të punës apo vendit të caktuar të cilin rregullisht e ndjek anëtarët tjetër i familjes
- ✓ Largim nga shtëpia pavarësisht të pronësisë
- ✓ Ndalim që të posedojë armë zjarri apo armë tjetër apo e njëjta t'i merret

- ✓ Detyrimisht të kthejë sendet të cilat janë të nevojshme për kryerjen e nevojave të përditshme të familjes
- ✓ Mbajtje të detyrueshme ligjor të familjes
- ✓ Detyrimisht të vizitojë këshillimoren përkatëse
- ✓ Mjekimi i detyrueshëm i kryerësit nëse e keqpërdor alkoholin, drogën dhe substancat tjera psikotrope apo ka sëmundje psiqike
- ✓ Detyrimisht të kompensojë shpenzimet mjekësore apo shpenzimet tjera të shkaktuara nga dhuna në familje

Masat e përkohshme të mbrojtjes kërkohen me parashtrimin e propozimit deri te gjykata kompetente në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo përmes qëndrës për punë sociale, ndërsa qendra për punë sociale mundet që drejtëpërdrejtë të parashtrijë propozim me pëlqim të viktimës. Propozimi për shqiptimin e masës të përkohshme mund të parashtrohet pavarësisht nëse zhvillohet procedurë penale.



B. Mbrojtja penale juridike – procedura penale

Dhuna në familje është vepër penale. Për kryerësit e dhunës janë paraparë dënime me burg. Procedurat penale inicohen nga ana e policisë sipas detyrës zyrtare pa kërkuar pëlqimin tuaj, përveç për veprën penale lëndim trupor, për të cilën nevojitet pëlqimi juaj me shkrim. Nevojitet që të paraqisni dhunën në stacionin më të afërt policor apo të paraqiteni me telefon. Kërkoni që të flisni me nëpunësin policor i cili punon në raste të dhunës në familje. Pasiqë të jepni deklaratë, nëpunësit policor do të grumbullojnë edhe dëshmi tjera dhe bashkarisht me kallëzimin penal do i dorëzojnë në prokurorinë kompetente publike (PKP), e cila do i përcjellë në gjykatën kompetente. Nëse jeta e juaj apo jeta e të afërmeve tuaj është në rrezik serioz, gjykata është e detyruar që të urdhërojë largimin urgjent të dhunuesit nga shtëpia dhe t'i lëshojë urdhër për ndalim që të mos afrohet afër jush. Në njëjtën kohë e njofton qendrën kompetente për punë sociale që të ndër marrë masa për mbrojtjen tuaj. Nëpunësit policorë duhet t'ju informojnë për masat që do të prezantohen kundër kryerësit të dhunës

Nëse nëpunësit policorë nuk parashtrojnë kallzim penal në prokurorinë kompetente publike, ju vetë mundeni që të parashtroni propozim deri te PTHP apo padi private deri te gjykata themelore, në afat prej tre muajsh nga dita e dhunës. Nëse keni frikë që të dëshmoni para gjykatës në prani të dhunuesit, kërkoni nga gjykatësi që të dëshmoni pa praninë e tij.

Gjykata pastaj merr aktvendim me të cilin e dënon dhunuesin apo e refuzon akuzën, apo e liron nga akuzat. Lloji i dënimit mund të jetë: dënim me burg, masë alternative (dënim me kusht, vërejtje gjyqësore etj) apo dënim në para. Nëse nuk jeni të kënaqur nga aktgjykimi, keni të drejtë në ankesë në Gjykatën e Apelit në afat prej 15 ditësh nga pranimi kopjes të aktgjykimit.

UNË NUK JAM VIKTIMË, POR E DIJË SE KUSH VUAN NGA DHUNË NË FAMILJE. KU TË DREJTOHEM DHE ÇFARË TË BËJ?



Çdo person që e din, apo ka bazë për të dyshuar se në familjen e tij, në fqinjësi apo në afërsinë tjetër të drejtëpërdrejtë ndodh dhunë në familje, ka për detyrë që këtë ta paraqes në polici.

Nëse dyshoni, por ju duhet mbështetje dhe më shumë informata për njohjen e dhunës apo për të ndihmuar viktimën, ju lutemi drejtoheni në një nga institucionet e përmendura në pikën 3.



KU MUND TË DREJTOHEM PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

- ✓ Shoqata dhe klinika juridike të cilat janë të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike falas
- ✓ Avokatë me kompetenca të fituara për dhënien e ndihmës juridike dytësore
- ✓ Në zyrat rajonale të Ministria e Drejtësisë (lista e kontakteve në shtojcë):

Njësitë rajonale	Telefonat
Berovë	071 205 324
Manastir	071 223 392
Makedonski Brod	071 223 075; 078 640 786
Vinicë	071 213 964
Vallandovë	071 213 925
Gjevgjeli	071 224 678; 071 216 267
Gostivar	071 223 180
Dibër	071 223 768
Delçevë	071 283 948
Demir Hisa	075 766 695
Kavadarë	075 659 855
Kërçovë	071 224 652
Koçanë	071 221 580
Kratovë	
Kriva Pallankë	071 224 580
Krushevë	071 227 808
Kumanovë	071 227 962

Njësitë rajonale	Telefonat
Negotinë	071 223 191
Ohër	071 221 908
Prilep	076 232 886
Probishtip	078 330 434
Radovish	070 261 310
Resnjë	071 221 246
Sveti Nikole	071 227 862
Strugë	071 223 015
Strumicë	071 224 526
Tetovë	071 227 893
Veles	
Shtip	071 221 484; 070 821 089
Karposh	071221381
Qendra	078 442 006
Kisella Vodë	071 224 104
Gazi Babë	071 213 798
Çairit	



INFORMOHU PËR NDIHMËN JURIDIKE FALAS

www.pravnapomos.mk

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Drejtësisë